

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kushtoi 4.7 mln euro, rruga Vllahinë-Poçem shembet 2 vite pas ndërtimit nga “Shkëlqimi 07” dhe “Fusha”
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/29/kushtoi-4-7-mln-euro-rruga-vllahine-pocem-shembet-2-vite-pas-ndertimit-nga-shkelqimi-07-dhe-fusha/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:52:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 09:51:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	46be95b42426809c50022ec260f4ca2a2518da2b89ae2f945b6fbdfb543dac
TEKSTI	90005135f118448425b8280f500485a6ad6d1111f6da09dc46f0390794e62cb3
PAMJA	3ebe1aa84b78384820309f9c6a07a2da2e21a487ae7d11c7ea6a0fd5c460ea44

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	16dd868562ef46c763029e1799186c0c9fb41b213349fb457f5ac75c75767cb6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f52a1d397c683d722882998d1b0c047f87c1de2f74016889fd5b4e655403fa0f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/16dd868562ef46c763029e1799186c0c9fb41b213349fb457f5ac75c75767cb6>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Kushtoi 4.7 mln euro, rruga Vllahinë-Poçem shembet 2 vite pas ndërtimit nga "Shkëlqimi 07" dhe "Fusha"

11:51 : 29/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Rreth 15 kilometra rrugë, një investim prej miliona eurosh dhe vetëm dy vite pas përfundimit, aksi Vllahinë-Poçem përballet me dëmtime në disa segmente të tij.

Rruga, e cila lidh zonat e Selenicës me Mallakastrën dhe më tej me aksin Levan-Tepelenë, u rikonstruktua në kuadër të projektit për përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe asaj turistike në Shqipëri.

Sipas tabelës së projektit të vendosur në aks, investimi ka një vlerë prej 4 milionë e 720 mijë e 655 euro, me TVSH, ndërsa punimet janë realizuar nga bashkimi i kompanive "Shkëlqimi 07" dhe "Fusha". Afati i parashikuar për realizimin e punimeve ka qenë 487 ditë.

Punimet nisën në vitin 2023 dhe rruga përfundoi në vitin 2024, por tashmë, në disa pjesë të saj, janë shfaqur çarje, deformime dhe ulje të trupit të rrugës.

Lexo edhe:

[Degradon Unaza e poshtme e Burrelit, rruga që kushtoi 1.2 milionë euro totalisht e pakalueshme](#)

[Shembja e rrugës në Prishtinë: Çfarë dihet dhe çfarë mbetet e paqartë](#)

Problematika më e dukshme paraqitet pranë fshatit Karbunar, ku rreth 400 metra të aksit janë prekur nga rrëshqitja e tokës. Lëvizja e terrenit ka dëmtuar asfaltin dhe ka sjellë deformime në sipërfaqen e rrugës, duke kërkuar ndërhyrje për stabilizimin e segmentit.

Dëmtimet ngrejnë pikëpyetje mbi qëndrueshmërinë e rrugës dhe masat e marra për stabilizimin e terrenit gjatë projektimit dhe ndërtimit të saj.

Mbetet për t'u parë nëse problematikat janë shkaktuar vetëm nga lëvizja natyrore e tokës apo nëse ka pasur mangësi në projektim, zbatim apo në masat mbrojtëse të parashikuara për këtë segment.

TË GJITHA



Kushtoi 4.7 mln euro, rruga Vllahinë-Poçem shembet 2 vite pas ndërtimit nga "Shkëlqimi 07" dhe "Fusha"

11:51 : 29/09/2026



Operacion kundër kultivimit të kanabisit në Qafështamë, dëgjohej të shtëna me armë

11:44 : 29/09/2026



Rritet fuqia politike e Vangjel Tavos, gruaja e tij emërohet drejtoreshë e Fondit të Kujdesit Shëndetësor

11:44 : 29/09/2026




"Plagjiaturë me temën e diplomës" – PD kallëzon në SPAK ministren e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu

11:29 : 29/09/2026



SPAK refuzon kërkesën për pjesëmarrjen e Veliajt në mbledhjen e Këshillit Bashkiak

11:17 : 29/09/2026



Identifikohen dy persona të zhdukur gjatë luftës në Kosovë

11:15 : 29/09/2026



Tabaku takon Hofreiter: Shqipëria duhet të zgjedhë mes integritetit në BE dhe korrupsionit

11:09 : 29/09/2026

Investimi synonte të përmirësonte lidhjen mes zonave të Selenicës dhe Mallakastrës, të lehtësonte qarkullimin e mjeteve dhe të ndikonte në zhvillimin ekonomik dhe turistik të zonave përgjatë këtij aksi.

Por vetëm dy vite pas përfundimit të punimeve, një pjesë e rrugës kërkon ndërhyrje për shkak të dëmtimeve të krijuara, ndërsa mbetet për t'u përcaktuar shkaku i tyre dhe mënyra se si do të ndërhyhet për rikthimin e segmentit në gjendjen e projektuar./ News24

Etiketa: Fusha shembet rruga Vllahinë-Poçëm "SHKELQIMI 07"

Lajme të lidhura



Degradon Unaza e poshtme e Burrelit, rruga që kushtoi 1.2 milionë euro totalisht e pakalueshme

10:11 : 23/04/2026



Shembja e rrugës në Prishtinë: Çfarë dihet dhe çfarë mbetet e paqartë

15:44 : 30/03/2026



Vijojnë shembjet, kësaj here rruga në Picrragë të Krujës/ VIDEO

12:43 : 25/02/2026



Shembet rruga Kuç-Qeparo, Berisha nxjerr PAMJET: Gjurmët e hajdutësisë së Rilindjes!

15:16 : 19/02/2026



Shembet rruga në Dukagjin/ Izolohen dhjetëra banorë, shkëputet energjia elektrike

16:12 : 03/01/2026



Inxhinieri i "Fushës" në krye të bashkisë/ PD: Nuk përfaqëson Vlorën, u komandua për të firmosur paligjshmëri

17:09 : 22/09/2025



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

